



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT

Duke u bazuar në Nenin 62, Paragrafi 3 të Ligjit Nr. 03/L – 040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe në Nenin 57, Shkronja e. të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. Nr. 110-391, si dhe bazuar në Ligjet që e rregullojnë fushën e arsimit parauniversitar (Ligji Nr. 02/L-52, Ligji Nr. 03/L-068, Ligji Nr. 04/L-32 dhe Ligji Nr. 04/L-138) dhe në funksion të rritjes së cilësisë së arsimit në Komunën e Prishtinës, me qëllim që të rritet niveli i transparencës me rastin e punësimit të stafit udhëheqës, profesional e ndihmës në institucionet edukativo-arsimore e aftësuese (IEAA) të kësaj komune, në mënyrë që sa më shumë që të jetë e mundur të minimizohet politizimi, familjarizmi dhe joprofesionalizmi në fushën e arsimit, Drejtori i Drejtorisë Komunale të Arsimit (DKA) merr:

V E N D I M

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E PRISHTINËS - OPŠTINA PRISTINA
DREJTORIA PËR ARSIM DHE KULTURË-DIREKCIJA ZA PROSVETU I KULTURU

PËR TRANSPARENCË NË ARSIM 03 Nr./Bf. 39 Dt. 05.05.2014

Përzgjedhja kandidatëve për mësimdhënës apo personel tjetër profesional e ndihmës të IEAA për intervistim nga Komisioni për Zgjedhjen e Personelit Arsimor, i cili përbëhet nga dy përfaqësues të DKA-së (njëri nga anëtarët mundësisht angazhohet një ekspert i pavarur i arsimit) dhe nga drejtori i institucionit përkatës bëhet në mënyrë publike, duke i prezantuar rezultatet e kandidatëve që kanë aplikuar në konkurs dhe rezultatet e kandidatëve që janë përzgjedhur për intervistim.

Me rastin e përzgjedhjes së kandidatëve për intervistim DKA obligohet që të ftojë për pjesëmarrje në cilësinë e vëzhguesve përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile që merren me çështjet e arsimit dhe të transparencës së institucioneve publike, si dhe përfaqësues të Komitetit për Arsim të Kuvendit Komunal të Komunës së Prishtinës.

Me rastin e intervistimit të kandidatëve për mësimdhënës apo personel tjetër profesional e ndihmës të IEAA:

1. Në intervistë do të ftohen 3 kandidatët më të mirë që i plotësojnë kushtet formale sipas ligjeve dhe udhëzimeve administrative (UA) përkatëse, bazuar në procedurën e përzgjedhjes dhe kriteret e paraseleksionimit të përcaktuara nga DKA në bazë të ligjeve dhe UA përkatëse;
2. Intervistat do të organizohen në institucionin përkatës ku kanë konkurruar kandidatët për t'u punësuar si mësimdhënës apo personel tjetër profesional e ndihmës;
3. Përveç Komisionit për Zgjedhjen e Personelit Arsimor, me rastin e intervistimit të kandidatëve do të ftohen për pjesëmarrje në cilësinë e vëzhguesve edhe përfaqësuesit e Këshillit Drejtues të shkollës, të Këshillit të Prindërve të shkollës dhe të Këshillit të Nxënësve të shkollës,

si dhe përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile që merren me çështjet e arsimit dhe të transparencës së institucioneve publike.

4. Obligohet DKA që t'i informojë përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile, ndërsa obligohet drejtori i institucionit përkatës që të informojë palët tjera të sipër-përmendura.

Përzgjedhja kandidatëve për drejtorë dhe zëvendësdrejtorë të IEAA për intervistim nga Komisioni Përzgjedhës, i cili përbëhet nga dy përfaqësues të DKA-së (njëri nga anëtarët mundësisht angazhohet një ekspert i pavarur i arsimit) dhe një përfaqësues i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) bëhet në mënyrë publike, duke i prezantuar rezultatet e kandidatëve që kanë aplikuar në konkurs dhe rezultatet e kandidatëve që janë përzgjedhur për intervistim.

Me rastin e përzgjedhjes së kandidatëve për intervistim DKA obligohet që të ftojë për pjesëmarrje në cilësinë e vëzhguesve përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile që merren me çështjet e arsimit dhe të transparencës së institucioneve publike, si dhe përfaqësues të Komitetit për Arsim të Kuvendit Komunal të Komunës së Prishtinës.

Me rastin e intervistimit të kandidatëve për drejtorë dhe zëvendësdrejtorë të IEAA:

1. Në intervistë do të ftohen 3 kandidatët më të mirë që i plotësojnë kushtet formale sipas ligjeve dhe udhëzimeve administrative (UA) përkatëse, bazuar në procedurën e përzgjedhjes dhe kriteret e paraseleksionimit të përcaktuara nga DKA në bazë të ligjeve dhe UA përkatëse;

2. Intervistat do të organizohen në institucionin përkatës ku kanë konkurruar kandidatët për t'u punësuar si drejtor apo zëvendësdrejtor;

3. Përveç Komisionit Përzgjedhës, me rastin e intervistimit dhe mbrojtjes publike të Programit Zhvillimor të kandidatëve për drejtorë dhe zëvendësdrejtorë, do të ftohen për pjesëmarrje në cilësinë e vëzhguesve edhe përfaqësuesit e Këshillit Drejtues të shkollës, të Këshillit të Prindërve të shkollës, të Këshillit të Nxënësve të shkollës, mësimdhënësit, prindërit, anëtarë të komunitetit dhe përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile që merren me çështjet e arsimit dhe të transparencës së institucioneve publike.

4. Obligohet DKA që orarin e intervistave ta bëjë publike dhe t'i informojë përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile, ndërsa obligohet Këshilli Drejtues i shkollës përkatëse që të informojë palët tjera të sipër-përmendura.

Vendimi i dërgohet:

- Kryetarit të Komunës
- Drejtorive të IEAA
- DKA-së
- QSHQK



Drejtori

Thaçi

Jusuf Thaçi

**Prishtinë, më
5 maj 2014**